

TERMA DHE KUSHTE

Besmir Nurce P.F / 2 BG Group pranon t'ju japë me qira një automjet mbi bazën e këtyre Kushteve të Përgjithshme të Qirasë, të cilat përfshihen në informacionin e dhe kushtet e Kontratës së Qirasë, të cilën ju keni firmosur. Me marrjen me qira të automjetit të sipërpërmendur, ju pranoni kushtet e Kontratës së Qirasë dhe merrni përsipër të veproni në përputhje me to në çdo detaj.

1. NATYRA E KONTRATËS

Të drejtat dhe detyrimet që lindin në këtë Kontratë, kanë fuqi mbi përdorimin e automjetit nga ana juaj dhe nuk mund të transferohen tek ju. Ju jeni në dijeni për faktin se automjeti i përket **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** dhe çdo tentativë transferimi apo dhënie me qira e tij nga kushdo tjetër është e pavlefshme. **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** ju lejon të përdorni automjetin vetëm sipas kushteve dhe termave të kësaj Kontrate.

Ju duhet të keni gjithnjë Kontratën e Qirasë me vete dhe t'ia tregoni atë policisë në rast se ju kërkohet.

2. KUSH MUND TA PËRDORË AUTOMJETIN

Automjeti duhet të përdoret vetëm nga ju ose çdo person tjetër që është autorizuar nga **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** në fillim të kësaj qiramarrjeje dhe të cilëve i janë shënuar të dhënat në dokumentet e qirasë (si "përdorues i autorizuar"). Ju pranoni se nuk do të lejoni të përdorë automjetin, askënd (përfshi dhe veten tuaj)që:

- Nuk përbush kërkesat minimale të **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** në lidhje me moshën dhe pasjen e një lejeje për drejtim automjeti të vlefshme në kohën dhe vendin e qiramarrjes, si dhe të çdo kërkesë tjetër minimale të nevojshme në kohën dhe vendin e qiramarrjes që mund t'ju bëhen të ditura para fillimit të qirasë; ose
- Është tejet i lodhur ose nën influencën e alkoolit, drogave, medikamenteve apo të çdo lloji substance tjetër të ligjshme apo të paligjshme të cilat paaftësojnë apo cenojnë ndërgjegjen apo aftësinë e tyre për të reaguuar.
- Nese ju lejoni që një person i paautorizuar nga **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** në fillim (ose gjatë) qiramarrjes të përdorë automjetin ,atëherë **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** rezervon të drejtën t'ju gjobise

MARRJA/DORËZIMI DHE KTHIMI

a. **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** ju dorëzon automjetin në kushte përgjithësisht të mira fizike dhe funksionimi, të plotësuar me të gjitha dokumentet, pjesët dhe aksesorët e nevojshëm.

b. Ju pranoni të ktheni automjetin tek **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** në të njëjtat kushte në të cilën ai ju është dorëzuar në fillim të qirasë, duke marrë parasysh vjetrimin normal dhe të pranueshëm nga përdorimi, me të njëjtat dokumente, pjesë dhe aksesore, në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentet e qirasë.

c. Ju dhe **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** do të kontrolloni gjendjen e automjetit para fillimit të qirasë dhe në momentin e përfundimit të saj. **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** do t'ju vë në dispozicion një dokument ku shënohen të gjitha defektet e pranuar nga ty dy palët. Ju pranoni që ju do të jeni përgjegjës ndaj **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** në çdo lloji situatë për çfarëdo humbje apo dëmtim të automjetit, dokumenteve të tij, pjesëve të tij apo aksesorëve të tij gjatë periudhës së qirasë suaj. **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group**

d. Automjeti duhet të kthehet në vendin e caktuar të **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** brenda orëve normale të punës të zyrës në fjalë të **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** . Nëse e ktheni automjetin jashtë këtyre orëve ju duhet të veproni në përputhje me udhëzimet e veprimeve jashtë orari për atë pikë të **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** , rast në të cilin ju do të mbeteni tërësisht përgjegjës për çdo humbje, vjedhje apo dëmtim të automjetit deri në orën e ri-hapjes së zyrës në fjalë. Nëse ju nuk veproni sipas këtyre udhëzimeve ju do të jeni tërësisht përgjegjës për çdo humbje, vjedhje apo dëmtim të automjetit si dhe për pagesa ekstra që lidhen me kohën, për shërbime të tjera opsionale apo për pagesa të përmendura në dokumentin e qirasë, deri në momentin kur punonjësit e **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** të marrin në dorë automjetin.

e. Nëse **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** ka rënë dakord që ju të ktheni automjetin në një vend të ndryshëm nga vendi i qiramarrjes, apo nëse **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** ka pranuar të marrë automjetin diku tjetër, ju do jeni përgjegjës për çdo humbje, vjedhje apo dëmtim të automjetit deri në marrjen e tij nga **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** .

f. Nëse nuk ktheni automjetin në zyrën apo vendin e dorëzimit brenda kohës sëparashikuarnë kontratë("Kohës Ekstra" siç specifikohet në fjalinëpasardhëse), ju do të faturoheni për një ditë tjetër shtesë qiraje, duke përfshirëdhe çdo opsion ekstra të parashikuar në kontratë sipas çmimit përkatës, për çdo ditë apo pjesë të ditës që makina kthehet me vonesë. "Koha Ekstra" është koha shtesë e lejuar për kthimin e automjetit, e shënuar në kontratën e qirasë mbi periudhën 24-orëshe të qirasë, dhe nëse nuk parashikohet aty, ajo është60 minuta.

g. Ju pranoni që **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** ka të drejtë t'ju faturorë një shtesë të arsyeshmenë çmim nëse në kthim, automjeti ka nevojë për më shumë se larjen tonë standarde për t'u kthyer në gjendjen në të cilën ju është dorëzuar dhe për të lejuar dallimin e saktë të dëmtimeve të mundshme.

h. **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** rezervon të drejtën të përfundojëkontratën e qirasës së automjetit menjëherë nëçdo kohë, nëse **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** konsideron se ekzistojnë arsye të forta për të bërë një gjë të tillë, dhe në këto raste **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** do të ri-marrë automjetin nga ju direkt ose nëpërmjet një agjenti dhe kostot e ri-marrjes do t'ju faturohen juve.Të njëjtat kushteveprojnë edhe nëse ju nuk zbatoni Kushtet dhe Termat pjesërisht apo në tërësi. Anulimi i qirasë së automjetit rezulton në anulimin total të sigurimit të automjetit dhe sigurimit të jetës.

3. DETYRIMET TUAJA NDAJ DËMTIMIT DHE VJEDHJES

Ju si qiramarrësi automjetit jeni plotësisht përgjegjës për të gjitha dëmtimet e makinës: brenda kabinës (sediljet, tapiceria, kroskoti, radio-kasetofon, CD-player, etj), dëmtime të bagazhit, dëmtim apo humbje të pasqyrave, dëmtime dhe humbje të gomave tasave apo të disqeve, dëmtime të pjesës së poshtme të automjetit, humbje të dokumenteve të automjetit si dhe dëmtime të tij si pasojë e mbingarkesës. Në rast aksidenti ju duhet të veproni në përputhje me rregullat e parashikuara në pikën 11 të këtij dokumenti.

i. apo kompeticioni tjetër;

ii. në kundërshtim me rregullat e trafikut të parashikuara nga Kodi Rrugor i vendit;

iii. për qëllime të jashtëligjshme;

iv. për ta ri-dhënë me qira tek dikush tjetër;

v. për ta përdorur në zona të ndaluara si p.sh. pista aeroporti, zona ushtarake etj;

vi. për të trajnuar persona të tjerë në drejtimin e makinës (si auto-shkollë);

vii. në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij dokumenti.

Përdorimi i mjeteve jashtë shtetit është subjekt i disa kufizimeve që lidhen me arsye teknike. Automjetet e marra me qira nga **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** mund të përdoren jashtë Shqipërisë, por ju duhet të njohoni **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** para marrjes me qira. Sigurimi i automjeteve të **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** P. është i vlefshëm vetëm brenda territorit të Shqipërisë, dhe në pikat kufitare ju duhet të blini sigurim ekstra për automjetin cili do të mbulojë udhëtimin tuaj jashtë këtyre territoreve. Gjithashtu automjeti nuk mund të përdoret kudo jashtë Shqipërisë (vetëm në Maqedoni, Mal të Zi, Kosove,) Në rast se ju si qiramarrës nuk u bindeni këtyre kushteve, ju do të jeni tërësisht përgjegjës për çdo humbje, dëmtim apo vjedhjen e automjetit si dhe çdo kosto që i shkaktohet **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** prej këtij veprimi, në çdo lloj rrethane.

4. PËRDORIMI I NDALUAR I AUTOMJETIT

a. Ju si qiramarrës i automjetit jeni i autorizuar ta përdorni atë në bazë të kushteve të këtij paragrafi, si dhe paragrafit 2 të mësipërm, dhe ta përdorni gjatë gjithë kohës në mënyrë të përgjegjshme. Nëse ju nuk u bindeni këtyre kushteve, ju do të jeni përgjegjës për çdo lloj humbje që i shkaktoni **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** si pasojë e sjelljes tuaj jashtë normave të përmendura më lart. Në rast mospërputhjeje me këto kushte, sigurimi i automjetit anulohet tërësisht. **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** rezervon të drejtën të ri-marrë automjetin në çdo kohë nëse ju nuk përdorni automjetin e marrë me qira sipas këtyre termave dhe kushteve, duke ju faturuar gjithashtu dhe kostot që kjo mund të sjellë.

b. Ju duhet të kujdeseni për automjetin dhe të siguroheni që është i mbyllur dhe i parkuar në një vend të sigurtë në çdo kohë gjatë periudhës së qirasë. Ju duhet të përdorni rripat e sigurimit, rripat e fëmijëve dhe të tjera masa mbrojtëse gjithmonë në mënyrën e duhur dhe sipas ligjit. Ju duhet të mbani ndezur ndriçuesit gjatë gjithë kohës sipas Kodit Rrugor Shqiptar.

c. Ju duhet të përdorni karburantin e duhur për automjetin, dhe, kur keni përdorur atë për më shumë se 1000km, të kontrolloni nivelin e vajit dhe fluideve të tjera si dhe t'i rimbushni sipas nevojës së automjetit. Në rast problemi mekanik të automjetit ju duhet të kontaktoni **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** menjëherë në pikat e kontaktit të shënuara në Kontratën e Qirasë. Automjeti nuk mund të riparohet askund dhe nga askush, pa marrë më parë aprovimin e **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group**

d. Ju nuk mund të përdorni automjetin e marre me qira nga **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group**

i. për transport pasagjeresh kundrejt pagesës (si taksi etj.);

ii. për transport mallrash me pagesë;

iii. për të tërhequr, apo për të shtyrë ndonjë automjet, rimorkio apo objekt tjetër;

iv. jashtë rrugëve të makinave, apo në rrugë jo të përshatshme;

v. të mbi-ngarkuar, ose me ngarkesa të pa siguruar mirë;

vi. për të transportuar objekte ose substanca të cilat dëmtojnë apo ndotin automjetin;

e. për të marrë pjesë në asnjë lloj gare apo automobilistike janë ekuivalente me totalin e shënuarnëkontratën e qirasë, dhe në rast se një kontratë e tillë nuk ekziston, detyrimi juaj është ekuivalent me tarifën e publikuara nga **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** dhe të vlefshme në periudhën e marrjes me qira. Pagesa e qirasë duhet bërë plotësisht në momentin që automjeti kthehet tek **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** ; nëse pagesa nuk behet e plotë ju pranoni t'ipaguani **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** shumën e detyruar plus një interes prej 6% mbi interesin e Euribor të asaj kohe. Gjithashtu ju pranoni të paguani **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** për çdo shpenzim që ka të bëjë me kërkimin dhe marrjen e shumës që ju i detyroheni. **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group**

Nëse ju dëshironi të paguani me Kartë Krediti, ju duhet të autorizoni **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** P.F në momentin e firmosjes së Kontratës së Qirasë, të rezervojë/bllokojë në kartën tuaj të kreditit një shumë parash që të përfshijë pagesën e qirasë së automjetit. Gjithashtu, ju autorizoni **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** të marrë direkt nga karta juaj e kreditit shuma parash për të zhdëmtuar kostot e shkaktuara nga ju gjatë periudhës sëqirasë si për shembull: për dëmtime të automjetit, për humbje të pjesëve dhe të dokumenteve, për rimbushje me karburant (ju duhet të ktheni automjetin të mbushur plot me karburant ose në nivelin në të cilin ju është dorëzuar), për pastrim të automjetit, për pagesë të gjobave të trafikut dhe të parkingut, si dhe një shumë administrative që përfshin përgatitjen e dokumentacionit për pagesat e mësipërme.

f. Ju si dhe çdo person që ju, me aprovimin e **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** , deklaroni si pagues të qirasë së automjetit, jeni së bashku përgjegjës për pagimin e plotë të qirasë. Nëse ju deklaroni dikë tjetër si pagues të qirasë së automjetit, ju pranoni që jeni të autorizuar për të bërë këtë veprim nga ai person.

5. DETYRIMET

a. Për çdo marrje me qira që ju kryeni nën këtë KontratëQiraje, detyrimet e shënuara në këtë kontratë reflektojnë përdorimin tuaj të automjetit që nga fillimi i qirasë. Këto detyrime përfshijnëqiranën e automjetit si dhe opsione të tjera që ju keni zgjedhur në momentin e marrjes me qira plus taksat (TVSH).

b. Detyrimi bazë për marrjen me qira të automjeteve ështënjë ditë qiraje (24 orë që nga momenti i marrjes me qira, ndonëse sipas dëshirës automjetin mund ta mbani për më pak kohë) dhe përfshin sigurimin e automjetit si dhe shërbime të tjera të shënuara nëKontratën e Qirasë.

c. Detyrime të tjera të kërkuara nga autoritetet mund të nevojiten p.sh si rrjedhim i qarkullimit në zona të caktuara kur **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** është i detyruar të paguajë për lejimin e qarkullimit, nga të cilat ju do të mbuloni pjesën që ju takon sipas llojit të lejes apo kohës së përdorimit; si Taksë e Shoferëve të Rinj (që do të aplikohet nëse ju apo ndonjëri nga përdoruesit e tjerë të regjistruar jeni nën 25 vjeç dhe me më pak se 5 vite eksperiencë në drejtim automjeti), etj.

d. Gjithashtu, përveç totalit të shënuar në Kontratën e Qirasë, detyrimet tuaja mund të ndryshojnë për të përfshirë pagesa për: dëmtime të automjetit, humbje të pjesëve dhe të dokumenteve, rimbushje me karburant, pastrim të automjetit, gjoba trafikuro dhe parkingu, si dhe një shumë administrative që përfshin përgatitjen e dokumentacionit për pagesat e mësipërme.

e. Totali i pagesës mund të ndryshojë edhe pas kthimit të automjetit (nëse **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** mëson me vonë se ju keni marrë gjoba, etj).

6. RIMBUSHJA E KARBURANTIT

a. Automjeti i marrë me qira do t'ju jepet i mbushur plot me karburant. Nëse ju e ktheni automjetin me më pak karburant se ç'e keni marrë, ju duhet të paguani për rimbushjen me karburant si dhe për shërbimin e rimbushjes nga **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group**. Pagesa që do të kryejë klienti është 2 Euro / Liter mangesi.

b. Sidoqoftë, nëse ju keni zgjedhur sipas kontratës, të parapaguani për një rezervuar të plotë, atëherë ju mund ta ktheni automjetin në çfarëdo niveli të karburantit (megjithatë nuk do t'ju njihet asnjë kredit për karburantin që mund të ketë mbetur në automjet). Në këtë rast, ju duhet thjesht të paguani për një rezervuar të plotë karburanti siç është shënuar në Kontratën e Qirasë.

7. PËRGJEGJËSIA E PRONËS

Besmir Nurce P.F / 2 BG Group NUK mund të mbahet përgjegjës për çdo lloj humbje apo vjedhje të pronës private të qiramarrësit apo pasagjerëve gjatë periudhës së qirasë, si dhe pas kthimit të automjetit tek **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group**. Kjo pronë është krejtësisht përgjegjësia juaj.

8. SIGURIMI I AUTOMJETIT

a. **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** (si çdo pronar automjeti në Shqipëri) është i detyruar të sigurojë automjetet para dhënies me qira. Ky sigurim është i përfshirë në qirarë dhe automjetit së bashku me sigurimin kasko.

b. Ju pranoi që të rimbursoni **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** sipas kërkesës nga sigurimi kasko, nëse **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** është i detyruar të paguajë kompaninë e sigurimit për të kompensuar një palë të tretë që ju keni aksidentuar, nëse kjo palë e tretë dëmtohet fizikisht ose vdes si pasojë e drejtimin tuaj të papërgjegjshëm të automjetit ose nëse ju shkelni ndonjë klauzolë të paragrafit 2 ose 5 të këtyre Termave dhe Kushteve.

9. AKSIDENTET, VJEDHJA, DHE VANDALIZMI

a. Ju duhet të kontaktoni menjëherë Policinë (tel.: 129 brenda Shqipërisë) dhe **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** (+355696838939 ose ne **Instagram** **perfect_car_rental_tirana** ose **Facebook Perfect Car Rental** ose email: 2bggroup22@gmail.com) në rast aksidenti, humbjeje, dëmtimi apo vjedhjeje të automjetit.

b. Në rast aksidenti me një palë të tretë, nuk duhet të pranoni fajin, të shfaqësoni palën e tretë, apo t'u jepni atyre para për të mbyllur çështjen. Në këtë rast ju duhet të kontaktoni menjëherë Policinë dhe **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group**, dhe të merri informacionin e palës së tretësi dhe të ndonjë dëshmitari okular.

c. Në rast aksidenti ju duhet të plotësonin Raport Aksidenti sapo të ktheni automjetin tek **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group**. Në rast vjedhjeje të automjetit ju duhet të ktheni çelësat e automjetit tek **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** dhe të plotësonin Raport Vjedhjeje. Nëse ju nuk u bindeni klauzolave të këtij paragrafi 11, ju do të jeni plotësisht përgjegjës për çdo aksident apo vjedhje të automjetit.

d. Ju pranoi të bashkëpunoni plotësisht me **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** dhe siguruesit e automjeteve të **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** në çdo investigim apo proces gjyqësor të çelur si pasojë e dëmtimit, humbjes apo vjedhjes së automjetit që ju keni marrë me qira.

10. KUFIJTË E PËRGJEGJËSISË

a. Në bazë të paragrafit 12(b), **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** nuk mund të jetë përgjegjës ndaj jush apo ndaj çdo palë të tretë për humbje dhe dëmtime si pasojë e dhënies me qira të automjetit, përveçse nëse këto humbje dhe dëmtime ndodhin për shkak të një veprimi apo mosveprimi të **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** nuk mund të jetë përgjegjës për asnjë lloj humbje apo dëmtim indirekt apo të paparashikuar.

b. Asgjënë paragrafin 12(a) nuk mund të përjashtojë apo kufizojë përgjegjësinë e **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** P.F ndaj dëmtimeve fizike apo vdekjes si pasojë e një veprimi apo mosveprimi të **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** apo çdo lloj përgjegjësie tjetër të parashikuara në ligj.

11. PARKIMI DHE THYERJET E RREGULLAVE

a. Ju si qiramarrës jeni krejtësisht përgjegjës për pagimin e gjobave të trafikut, detyrimeve të parkingut, si dhe gjobave të tjera apo pagesa të bllokimit dhe zhbllokimit të automjetit gjatë periudhës së qirasë dhe nëse këto gjoba nuk deklarohen apo vijne me poste, pasi është dorëzuar makina, qiramarrësi është përgjegjës dhe cdo gjobe apo kamate vonese do i mbahet në kartën e kreditit.

b. Nëse **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** detyrohet të paguajë gjoba dhe detyrime të tjera, ju pranoi që të paguan **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** P.F për shlyerjen e tyre si dhe për veprimet administrative të lidhura me to p.sh përgatitjen e dokumentacionit për pagesat e mësipërme etj.

c. **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** P.F, me kërkesë tuaj, mund t'ju vërë në dispozicion kopje të çdo gjobe të marrë gjatë periudhës së qirasë.

12. INFORMACIONI JUAJ

a. Duke firmosur këtë Kontratë Qiraje, ju deklaroni që nuk jeni kundër rruajtjes elektronike dhe përdorimit të informacionit tuaj nga **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** për arsye të ligjshme statistikore, kontroll kredie, si dhe për mbrojtjen e aseteve dhe aktivitetit të **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group**. Në rast se ju thyni rregullat e parashikuara në këtë dokument, **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** rezervon të drejtën që në rast nevojë të vërë informacionin tuaj në dispozicion të çdo palë të tretë me qëllim realizimin e zhdëmtimit tonë sipas ankesës apo për të parandaluar çdo lloj dëmi të mundshëm.

b. Ju kuptoni dhe pranoi që përdorimi nga ju i numrit të CDP (Corporate Discount Program) i lidhur me një kompani apo organizatë, e detyron **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** t'i ofrojë informacionin tuaj asaj kompanie apo organizate.

13. SALVATORY CLAUSE

Në rast se cilado nga dispozitat e kësaj kontrate rezultojnë të jetë ose bëhet plotësisht apo pjesërisht e pavlefshme, e paligjshme apo e pa-praktikueshme për shkak të ligjeve në fuqi, palët bien dakord që kjo nuk do të cenojë vlefshmërinë e kontratës apo pjesëve të saj të cilat nuk bien në kundërshtim me ligjin.

14. LIGJI NË FUQI

Besmir Nurce P.F / 2 BG Group synon të zgjidhë çdo lloj problem i apo mosmarrëveshjeje në mënyrë miqësore. Në rast se një zgjidhje e tillë është e pamundur, palët bien dakord që mosmarrëveshjet të zgjidhen sipas ligjeve shqiptare në fuqi nga Gjykata kompetente shqiptare.

15. Pranimi

Me firmosjen e marrëveshjes në faqen e parë, ju pranoi të gjitha kushtet e mësipërme si dhe:

- Të mbuloni të gjitha kostot e ardhura nga humbja apo dëmtimi nga ana juaj gjatë periudhës së qirasë, i dokumentacionit të automjetit si dhe të gjitha të ardhurat e munguara të shkaktuara nga mos-operimi i automjetit gjatë mungesës së dokumenteve të rregullta.
- Të njoftoni **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** për çdo gjobë të lëshuar nga policia për automjetin gjatë periudhës që e keni pasur atë me qira përfshi edhe ato të cilat mund t'i keni paguar.
- Të mbuloni kostot për çdo gjobë të lëshuar nga policia për automjetin gjatë periudhës që e keni pasur atë me qira.
- Të informoni **Besmir Nurce P.F / 2 BG Group** për çdo incident të ndodhur gjatë periudhës që keni pasur automjetin me qira, përfshi dhe rastet kur incidenti nuk ka pasur pasojë.